



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr. 266/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbaremore të kreditorit Kompania e Sigurimeve “I...”, me seli në Prishtinë, sheshi “...., me numër të biznesit ...., kundër debitorit Kompania e Sigurimeve “K...”, me adresë .... Prishtinë, me numër biznesi ...., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr.4/2019 të datës 11.01.2019 të Përmbaremit Privat Eset Murati, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 02.09.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit Kompania e Sigurimeve “K...”, me seli në Prishtinë, i paraqitur kundër urdhrit përmbaremore P.nr.4/2019 i datës 11.01.2019, i lejuar nga Përmbaremit Privat Eset Murati, me seli në Prishtinë.
- II. MBETET në fuqi urdhri përmbaremore P.nr.4/2019 i datës 11.01.2019, i lejuar nga Përmbaremit Privat Eset Murati, me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Përmbaremit Privat Eset Murati, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania e Sigurimeve “I...”, me seli në Prishtinë, në bazë të titullit ekzekutiv – aktvendimin mbi pajtimin gjyqësor të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Ekonomik II.Ek.nr.63/18 të dt. 06.06.2018, ka nxjerrë urdhrin përmbaremore P.nr.4/2019 të datës 11.01.2019, me të cilin ka caktuar zbatimin e përmbaremit, ndaj debitorit Kompania e Sigurimeve “K...”, me adresë .... Prishtinë dhe ka detyruar debitorin që kreditorit t’ia paguaj shumën prej 4.574.37 € ( katër mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër euro e tridhjetë e shtatë cent) dhe në emër të shpenzimeve të procedurës shumën prej 60.00 € (gjashtëdhjetë euro), si dhe shpenzimet e procedurës

përmbartimore të cilat do ti caktojë përmbartuesi privat, me ndalimin e mjeteve në cilëndo llogari, që është në emër të debitorit dhe të njëjtat të barten për pagesë në llogarinë e kreditorit.

Debitori përmes të autorizuarit të tij, në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se është i vetëdijshëm për obligimin e tij dhe se debitori do të kryejë obligimin e tij, duke kërkuar që përmbartimit të mos ekzekutohet, pasi që do të përfundoj pagesa në një të ardhme shumë të shpejt. Andaj i ka propozuar gjykatës që të pranohet prapësimi i tij si i bazuar, të refuzohet urdhri për lejimin e përmbartimit si dhe të shtyhet urdhri përmbartimor për disa ditë, duke ia dhënë mundësinë që debitorit të shlyej këto obligim.

Përmbartuesi privat në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ndër të tjera ka deklaruar se shkaqet e prapësimit janë të parapara në mënyrë decidive me nenin 71 të LPP –së dhe se me nenin 69 par 4 të LPP –së, është paraparë se: “Baza për prapësim duhet të mbështetet në prova të duhura, provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”. Ka shtuar se meqenëse debitori në prapësimin e ushtruar nuk ka ofruar kurrfarë prove me të cilat do të mbështeteshin pretendimet e tij, i ka propozuar gjykatës që në përputhje me nenin 73.3 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pa bazuar, kurse urdhrin P.nr.4/2019 të datës 11.01.2019, ta lëj në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim si dhe përgjigjes në prapësim të kreditorit, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar, nga fakti se debitori nuk ka ofruar asnjë provë me shkrim konform nenit 69 paragrafi 4 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore (tutje LPP), me të cilën do të mund të kërkonte anulimin e këtij vendimi, sipas kushteve të parapara me nenin 71 të LPP-së.

Gjykata erdhi në përfundim se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, për faktin se në prapësimin e debitorit nuk janë dhënë arsye që prapësimi të pranohet si i bazuar dhe të anulohet urdhri përmbartimor, ndërsa e ka lënë në fuqi Urdhrin e Përmbartuesit Privat P.nr.4/2019 të datës 11.01.2019, pasi që i njëjti është lejuar në bazë të dokumentit përmbartues (titullit ekzekutiv) – aktvendimit mbi pajtimin gjyqësor të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Ekonomik II.Ek.nr.63/18 të dt. 06.06.2018, i formës së prerë nga dt. 06.06.2018 dhe i ekzekutueshëm nga dt.22.06.2018.

Sipas dokumentit përmbarues (titullit ekzekutiv) - aktvendimit mbi pajtimin gjyqësor të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Ekonomik II.Ek.nr.63/18 të dt. 06.06.2018, debitori është detyruar që kreditorit të ia paguaj në emër të kompensimit të dëmit shumën prej 4.574.37 € ( katër mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër euro e tridhjetë e shtatë cent) dhe në emër të taksës për padi shumën prej 60 (gjashtëdhjetë euro), e të gjitha këto në afat kohor prej 60 ditëve në xhirollogarinë e palës paditëse.

Gjykata gjeti se dokumenti përmbarimor – aktvendimi mbi pajtimin gjyqësor të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Ekonomik II.Ek.nr.63/18 të dt. 06.06.2018, është dorëzuar në origjinal dhe i plotëson kushtet ligjore sipas nenit 38 par 1. të LPP-së, i cili përcakton se: *“Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarimi, kërkuesi i përmbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit– vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarimi, objekti i përmbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit”*.

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 22 par. 1, pika 1.1, përcaktohen dokumentet përmbaruese siç janë: *“vendimi përmbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbaruese;”*, ndërsa me nenin 23. par.1 përcaktohet se *“ vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit, kurse ujdi gjyqësore konsiderohet ujdia e arritur përpara Gjykatës dhe arbitrazhit si dhe marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit.”*, dhe nenin 24 par. 1 përcaktohet të LPP-së përcaktohet se: *“Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i përmbarueshem po qe se ka marrë formë të prerë, si dhe po qe se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare.”*, ndërsa me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se *“Dokumentit përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se urdhri për përbarim i caktuar mbi bazën e titullit ekzekutiv – ujdisë gjyqësore i plotëson kushtet për tu paraqitur si dokument përbarues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përbarimit, ngase janë plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 21, nenit 22 par.1 pika 1.1, nenit 23 par.1, nenit 24 par. 1 dhe nenit 27 të LPP-së, pasi që aktvendimi mbi pajtimin gjyqësor të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Ekonomik II.Ek.nr.63/18 të dt. 06.06.2018, i formës së prerë nga dt. 06.06.2018 dhe i ekzekutueshëm nga dt.22.06.2018, është i përbarueshëm dhe njëkohësisht i përshatshëm për përbarim, pasi që në të janë treguar palët përkatësisht kreditori dhe debitori, është përcaktuar shumta e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.266/22, datë 02.09.2022

Gjyqtarja  
Verona Dibra

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.